

TAKIMI BE - KOMITETI NËNMINISTROR SHQIPTAR

29 Janar 2010

Më datën **28.01.2010** u zhvillua në **Bruksel** takimi mes Bashkimit European dhe Komitetit Nënministor të Shqipërisë, për të diskutuar progresin në fushën e Tregtisë, Industrisë, Doganave dhe Taksave. Në këtë takim mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Standardizimit **Z. Bashkim Muça** dhe Drejtorja e Integritimit pranë kësaj Drejtorie **Znj. Kostanca Dedja**.



Përfaqësuesit e Komisionit European që morën pjesë në diskutim, vlerësuan progresin e bërë nga DPS në adoptimin e Standardeve Europiane, promovimin e informacionit të nevojshëm në komunitetin e biznesit për dobinë e standardizimit, shitjen e standardeve dhe nivelin e afrimit në organizatat ndërkombëtare CEN dhe CENELEC.

Referati i mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm i DPS, **Z. Bashkim Muça**, u vlerësua korrekt nga specialistët e Komisionit European, të cilët më pas debatuan për procesin e ngritjes dhe funksionimit të Bordit Drejtues dhe objektivit të anëtarësimit me të drejta të plota në **CEN** dhe **CENELEC**.

Ngritja dhe funksionimi sa më i shpejtë i **Bordit Drejtues**, e vetmja detyrë e lënë nga KE, mbetet prioritet për DPS. Ky proces ka filluar dhe drafti ka mbërritur në METE. Pritet së shpejti kalimi i tij për miratim në Këshillin e Ministrave.